



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:170454
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05756436

C.nr.2779/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtare Njomëza Berisha, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses B.B. me numër personal nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 579.75 euro, jashtë seance, me datë 30.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.B. nga Prizreni. **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësja të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore 01.08.2019 – 31.12. 2019, në shumën prej 61.96 euro;
2. Për periudhën kohore 01.01.2020 – 31.12.2020, në shumën prej 11.06 euro;
3. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 31.12.2021, në shumën prej 187.27 euro;
4. Për periudhën kohore 01.01.2022 – 30.06.2022, në shumën prej 319.64 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 579.75 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (22.08.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja B.B. nga Prizreni, në këtë gjykatë me datë 22.08.2022, përmes të autorizuarit të tij A.H. nga Prishtina, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të inflacionit në pagë.

Në padi ka theksuar se paditësja Besëlidhje Veseli është në marrëdhënie pune në gjimnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, si mësimdhënëse, dhe bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë, paditëses i takon kompensimi në emër të inflacionit. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Me parashtrësën e datës 03.04.2024, paditësja ka bërë precizimin e padisë, duke theksuar se paditësja ka pagën bazë në shumën prej 459.00 euro dhe i takon e drejta në kompensim sipas inflacionit nga data 01.08.2019 deri me datën 30.06.2022, në shumë të përgjithshme prej 579.75 euro dhe atë, për vitin 2019 - $459 \times 2.7\% = 12.39$ euro për muaj $\times 5 = 61.96$ euro, për vitin 2020- $459 \times 0.2\% = 0.91$ euro për muaj $\times 12$ muaj $= 11.06$ euro, për vitin 2021 - $459 \times 3.4\% = 15.60$ euro për muaj $\times 12$ muaj $= 187.27$ euro dhe për vitin 2022 - $459 \times 11.6\% = 53.24$ euro për muaj $\times 6$ muaj $= 319.64$ euro.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditëses nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-

së për periudhën 2017 deri më 12.10.2022. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësit e lëshuar nga Komuna e Prizreni – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht paditësës B.B. është në marrëdhënie pune në gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren, si mësimdhënëse. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësës e që është shuma prej 459.00 euro Po ashtu gjykata bazuar në Indeksine e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *"Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të"*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *"Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë"*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *"Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve"* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësës i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë :

- Për periudhën Gusht - Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësës në vitin 2019 ka

qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 61.96 euro ($459 \times 2.7\% = 12.39 \times 5 = 61.96$ euro).

- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 11.01 euro ($459 \times 0.2\% = 0.91 \times 12 = 11.01$ euro).
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 187.27 euro ($459 \times 3.4\% = 15.60 \times 12 = 187.27$ euro).
- Për periudhën Janar – qershor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 319.64 euro ($459 \times 11.6\% = 53.24 \times 6 = 319.64$ euro)

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 152 të LPK-së ku parashihet që *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (22.08.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurit me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata pretendimet e të paditurës se kërkesa e paditëses është parashkruar e gjeti të pa bazuar, pasi që me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 22.08.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.08.2019 e deri më 30.06.2022, Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura gjykata konstaton se padia e paditëses për periudhën 01.08.2019 e deri më 30.06.2022 e precizuar me parashtrësën e datës 03.04.2024, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të LP-së ku parashihet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Numri i lëndës: 2022:170454
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05756436

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.2779/2022, datë 30.05.2024

G j y q t a r e

Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Numri i lëndës: 2022:170454
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05756436